

**PROCES-VERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime****PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Shërbim Mbikqyrje Punimesh në objektin: Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara, Bashkia Kolonjë**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

71247000-1 - Mbikëqyrja e punës së ndërtimit,

**VLERA E FONDIT LIMIT: nuk aplikohet**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kolonjë** ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E PRANIMIT/KUALIFIKIMIT****1.Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):**

a. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjise elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i rregjistruar në Shqipëri.

b. IBAN origjinal të leshuar nga Banka perkatese ku te jete nipti , numri i llogarise dhe Iban.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.943,datë.28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, si mëposhtë:

**PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

1. NP – 3 Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje dhe fasada

**PUNIME SPECIALE NDËRTIMI**

1. NS- 1 Punime për prishjen e ndërtimeve
2. NS- 8 Ndërtime parafabrikat betonarme,struktura metalike dhe druri

*Licensat duhet të jenë lëshuar sipas rregullave të VKM nr.759 datë 12.11.2014 “Për licensimin profesional të individëve dhe personave juridik që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, me VKM 943, datë 28.12.2016.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Janë përcaktuar Licencat profesionale të mësipërme për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë sipas përcaktimit të bëra në dispozitat e sipërcituara.

Kategoritë për ndjekjen e realizimin e punimeve të ndërtimit dhe niveli për çdo kategori punimesh zbatimi janë përcaktuar në mbështetje të plotë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.759, datë 12.11.2014 "Për Liçensimin profesional të individëve dhe personave juridik që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", (i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente, bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve që do realizohen sipas preventivit dhe projektit.

**3.** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik në liçensën e shoqërisë për Mbikqyrje/Kolaudimit të Punimeve të Zbatimit personelin kryesor inxhinierët si mëposhtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi

**Për secilin duhet të paraqiten:**

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma, CV
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht në 3 muajt e fundit.

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).*

**Argumentimi:** Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma "c" të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Vendosija e këtij kriteri për stafin është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit të zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përllogaritur për zbatimin e kësaj kontrate.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve për realizimin e kontratës në mbështetje të dispozitave të sipër permendura sepse nëpërmjet këtij kriteri bëhet përcaktimi nga ana e operatorit ekonomike listës së personelit kryesor që do të ndjek zbatimin e punimeve si pjesë e personelit të nevojshëm dhe të domosdoshëm për realizimin e kontratës pasi mbikqyrësi i punimeve do të jetë personi përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës referuar Udhezimit Nr.2, date 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" si dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

Referuar preventivit të punimeve të zbatimit i cili u është vënë në dispozicion në platformën elektronike të Agjensisë së Prokurimit Publik është parashikuar se do të kryhen punime, të cilat kërkojnë detyrimisht mbikqyrjen nga Inxhinier Ndërtimi me qëllim realizimin e procesit të punës në përputhje me projektin bazë.

4. Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertës së tyre duhet ti referohen VKM nr.354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", si dhe në mbështetje të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, Nr.5585 Prot "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016" "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

***Të gjitha ofertat me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar dhe me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr.354, datë.11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", do të skualifikohen.***

Operatori ekonomik duhet të respektojë legjislacionin në fuqi dhe tarifën minimale të shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve referuar VKM nr.354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", duke dorëzuar një ofertë të detajuar ekonomike e cila garanton Autoritetin Kontraktor në përmbushjen e termave të referencës.

**5.** Operatori Ekonomik duhet të ketë në ushtrim të veprimtarisë së tij edhe objektin që po prokurohet. Në respektim të udhëzimit nr. 05, datë.25.06.2021 të APP " Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", do të bëhet refuzimi **automatikisht** nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i ofertave nga operatorët ekonomike të cilët pas verifikimeve në faqen zyrtare të QKB rezultojnë se nuk kanë si objekt të veprimtarisë së tyre, objektin e prokurimit.

**6.** Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor **Bashkia Kolonjë** (me dokumentat e kërkuara), brenda **24 (Njëzetëkatër) orëve**, nga momenti i publikimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik të njoftimit të fituesit, përndryshe konsiderohet se e refuzon (heq dorë) dhe në këto kushte oferta do të skualifikohet.

**7.** Dokumentacioni i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik i shpallur fitues, në Zyren e protokollit **Bashkia Kolonjë**.

**8.** Nëse dokumentacioni nuk është në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor, subjekti skualifikohet, në mbështetje të dispozitave të legjislacionit të prokurimeve publike.

**9.** Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**10.** Për të dhënat mbi objektin për të cilin kërkohet shërbimi i mbikëqyrjes siç janë vendodhja e saktë e tij, shtrirja si dhe çdo element tjetër teknik i OE ti referohen termave të referencës bashkëngjitur dhe procedurës së prokurimit- elektronike me objekt: "**Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara, Bashkia Kolonjë**", me Nr. REF-17133-08-27-2024.

### **Komisioni i Prokurimit të Blerjeve të Vogla**

Kryetar

Anëtar

Anëtar